



Nr. Prot. _____

Tiranë ___/___/2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: **Operatorit ekonomikë “KLAJGER KONSTRUKSION” shpk.**
Adresa: **Rruga "Bardhok Biba", Njesia Administrative Nr.9, zona 9/1.**

Procedura e prokurimit/lotit: **“Procedurë e Hapur”, “Rikonstruksioni i rrugës “Grigor Cilka”.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-60471-02-27-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: **“Rikonstruksioni i rrugës “Grigor Cilka”**

Fondi limit: 99,632,583.88 (nëntëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre pike tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2023, miratuar me VKB Nr.126, datë 23.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarik duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.21, datë 06.03.2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik “LIS KONSTRUKSION” (EURO-ALB) & “LLAZO” shpk NUIS K66613407H & K24218401K

Vlera e ofertës = **68,023,581** (gjashtëdhjetë e tete milion e njëzete e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomik “RSM COMPANY” & “DESARET COMPANY” shpk NUIS 810802422 & K01816001J

Vlera e ofertës = **74,251,680** (shtatëdhjetë e katër milion e dyqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

- 3. Operatori ekonomik “KUPA” shpk** NUIS K51615512C
Vlera e ofertës = **74,993,713** (shtatëdhjetë e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mije e shtatëqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH.
- 4. Operatori ekonomik “CURRI” shpk** NUIS J67902718S
Vlera e ofertës = **75,141,090.45** (shtatëdhjetë e pesë milion e njëqind e dyzetë e një mije e nëntëdhjetë pike dyzetë e pesë) lekë pa TVSH.
- 5. Operatori ekonomik “INA” shpk** NUIS J61814009W
Vlera e ofertës = **76,601,747** (shtatëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e një mije e shtatëqind e dyzetë e shtate) lekë pa TVSH.
- 6. Operatori ekonomik “BEQIRI” shpk** NUIS J98624801V
Vlera e ofertës = **78,696,584** (shtatëdhjetë e tete milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mije e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.
- 7. Operatori ekonomik “Shendelli” shpk** NUIS K07924803N
Vlera e ofertës = **78,938,263** (shtatëdhjetë e tete milion e nëntëqind e tridhjetë e tete mije e dyqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.
- 8. Operatori ekonomik “B-93” shpk** NUIS J62903508R
Vlera e ofertës = **80,277,170** (tetëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e shtate mije e njëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.
- 9. Operatori ekonomik “PEPA GROUP GROUP” shpk** NUIS L42215009L
Vlera e ofertës = **84,076,032.22** (tetëdhjetë e katër milionë shtatëdhjetë e gjashtë mije e tridhjetë e dy pike njëzete e dy) lekë pa TVSH.
- 10. Operatori ekonomik “DENIS-05” shpk** NUIS K51518029B
Vlera e ofertës = **85,918,660.25** (tetëdhjetë e pesë milion e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mije e gjashtëqind e gjashtëdhjetë pike njëzete e pesë) lekë pa TVSH.
- 11. Operatori ekonomik “GLAVENICA” shpk** NUIS K17710805A
Vlera e ofertës = **85,952,489** (tetëdhjetë e pesë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e dy mije e katërqind e tetëdhjetë e nënte) lekë pa TVSH.
- 12. Operatori ekonomik “KLAJGER KONSTRUKSION” shpk** NUIS K51423028P
Vlera e ofertës = **86,022,654.20** (tetëdhjetë e gjashtë milion e njëzete e dy mije e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër pike dy) lekë pa TVSH.
- 13. Bashkimi i operatorëve ekonomik “BE - IS” & “A.L-ASFALT” shpk** NUIS K71412003A&K81511508A
Vlera e ofertës = **86,394,937** (tetëdhjetë e gjashtë milion e treqind e nëntëdhjetë e katër mije e nëntëqind e tridhjetë e shtate) lekë pa TVSH.
- 14. Operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” shpk** NUIS K61625001I
Vlera e ofertës = **89,488,738.10** (tetëdhjetë e nënte milion e katërqind e tetëdhjetë e tete mije e shtatëqind e tridhjetë e tete pike një) lekë pa TVSH.
- 15. Operatori ekonomik “BESTA” shpk** NUIS J62903182B

Vlera e ofertës = **89,684,984** (tetëdhjete e nënte milion e gjashtëqind e tetëdhjete e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

16. Operatori ekonomik “LIQENI VII” shpk

NUIS K01730502W

Vlera e ofertës = **94,558,562.90** (nëntëdhjete e katër milion e pesëqind e pesëdhjete e tete mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy pike nënte) lekë pa TVSH.

17. Operatori ekonomik “PE - VLA - KU” shpk

NUIS K61716013M

Vlera e ofertës = **95,405,894.77** (nëntëdhjetë e pese milion e katërqind e pese mijë e tetëqind e nëntëdhjete e katër pike shtatëdhjetë e shtate) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- Bashkimi i operatorëve ekonomik **“LIS KONSTRUKSION” (EURO-ALB) & “LLAZO” shpk** **NUIS K66613407H & K24218401K**

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” shpk & “Llazo” shpk nuk plotëson kërkesat sipas gërmës “c” të pikës 8.2 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit eskavatoriste, automakinist dhe buldozeriste, emer/mbiemer, profil i punës, numri dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerisë së aftësisë profesionale”* pasi për manovratorët nuk është deklaruar vlefshmëria e dëshmimeve të aftësisë profesionale për manovratorët.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” shpk & “Llazo” shpk nuk plotëson pikën 13 të Kapacitetit Teknik, të Dokumenteve Standarte të Tenderit gërmëa “b” ku përcaktohet: *“Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës”* pasi mjetet e marra me qera, konkretisht Autobetoniere me targe AA065AE, Autobetoniere me targe AA829SR, Autobetoniere me targe AA513NR dhe fadromë me targë AA113IM, janë deklaruar me kontratë qeraje me afat nga data 24.05.2022 deri me datë 24.05.2023, çka rezulton jashtë afatit të realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Ndërsa Autobetonieret e Kantierit të deklaruar në pronësi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, janë deklaruar pa targa, leje qarkullimi dhe numer shasie.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Euro-Alb” shpk & “Llazo” shpk nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit, lidhur me përcaktimin e përqindjeve të pjesëmarrjes në bashkëpunim. Nga verifikimi i Marreveshjes së Bashkëpunimit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se ndarja e punimeve në këto marreveshje është e pasakte pasi operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk (LIS KONSTRUKSION) shpk ka marrë 90.04 % të punimeve ndërsa operatori ekonomik “Llazo” shpk ka marrë përsiper 9.6 % të punimeve, në total 99.64 % të zerave të punimeve të preventivit të punimeve të venë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, nga 100 % e zerave të preventivit të punimeve që duhej të merrte përsiper bashkimi i operatorëve ekonomik.

- Bashkimi i operatorëve ekonomik **“RSM COMPANY” & “DESARET COMPANY” shpk** **NUIS 810802422 & K01816001J**

Operatori ekonomik “Desaret Company” shpk nuk plotëson pikën 3 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt”.....”* Nga verifikimi dokumentacionit të

paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se Operatori ekonomik “Desaret Company” shpk ka paraqitur deklaraten per Drejtuesin Teknik te punimeve ne objekt me inicialet D.TH me profesion **Inxhiniere Hidroteknike**, cka bie ne kundershkrim me Udhezimin Nr.2, date 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1, paragrafi 2, ku citohet se: “*Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi*”.

Bashkimi i operatoreve “Desaret Company & RSM Company” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne piken 13, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ne DST, ku percaktohet: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)*”. Nga verifikimi formularit permbledhes te vetedeklarimit, ne shtojcen e makinerive rezulton se Bashkimi i operatoreve “Desaret Company & RSM Company” shpk ka deklaruar mjetin Autobitumatrice, por nuk ka deklaruar targen dhe numrin e lejes se qarkullimit dhe numrin e shasise se mjetit. Bashkimi i operatoreve “Desaret Company & RSM Company” shpk nuk potëson pikën 5 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik duhet te kete nje punesim mesatar....*” pasi stafi inxhinierk dhe teknik rezulton i angazhuar ne kontratën me objekt “Rikonstruksion i rruges At Staf Melani” lidhur me Autoeitetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe financiare.

Bashkimi i operatoreve “Desaret Company & RSM Company” shpk nuk potëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.....*” pasi mjetet rezultojne te angazhuara ne kontratën me objekt “Rikonstruksioni i bllokut të kufizuar nga rrugët “Rikonstruksion i rruges At Staf Melani” lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe financiare, çka bie në kundërshtim edhe me kërkesën e gjermës “g”, “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklararon se mjetet dhe pajisjet e deklaruarat nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruarat ne procedurat te shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane*”.

- Operatori ekonomik “KUPA” shpk **NUIS K51615512C**

Operatori ekonomik Kupa Shpk nuk permbush kerkesat e pikes 2.3 te Kriterëve te Vecanta te Kualifikimit, ku percaktohet se: “*Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se ose Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel sa dyfishi i vlerës se fondit limit të kontratës që prokurohet*”. Pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit, rezulton se per kontraten e paraqitur me objekt: “Rikualifikim urban i bllokut qe kufizohet nga rruget Kastriotet, Gramozi,”, nuk eshte paraqitur Certifikata e marrjes ne dorezim.

Operatori ekonomik KUPA shpk, nuk ploteson piken 8/8.2, te Kriterëve te Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik ku percaktohet se: “*Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit teknik ndertimi, elektrikist dhe hidraulik, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument*”, pasi nga verifikimi ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se operatori ekonomik KUPA shpk, nuk ka deklaraur per punonjesit elektrikist dhe hidraulik, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.

- Operatori ekonomik “CURRI” shpk

NUIS J67902718S

Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Ekonomik e financiar, pika 3, te dokumenteve standarte te tenderit ku percaktohet: “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 dhe për vitin 2022 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. **(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit)**”. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetedeklarimit, rezulton se operatori ekonomik Curri Shpk nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 dhe 2022.

Operatori ekonomik Curri shpk, nuk ploteson pikën 8/8.2, të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, të Dokumentëve Standarte të Tenderit ku percaktohet se: “Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit teknik ndertimi, elektrikist dhe hidraulik, emrin/mbiemer, profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar këto dokument”, pasi nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimit rezulton se operatori ekonomik Curri shpk, nuk ka deklaruar për punonjësit Teknik ndertimi, elektrikist, hidraulik, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar këto dokument.

Operatori ekonomik Curri shpk, plotëson pikën 8.2, gërma” c” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, të Dokumentëve Standarte të Tenderit ku percaktohet se: “Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit eskavatoriste, automakinist dhe buldozeriste, emër/mbiemer, profil i punës, numri dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerisë së aftësisë profesionale” , pasi nuk është deklaruar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit numri dhe afati i vlefshmerisë së aftësisë profesionale për punonjësit Manovrator.

- Operatori ekonomik “INA” shpk

NUIS J61814009W

Operatori ekonomik “INA” shpk në deklaratën për drejtuesin teknik nuk ka deklaruar që drejtuesi teknik do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt cka bie në kundërshtim me kërkesën e pikës 3, të Kapacitetit Teknik, të Dokumentëve Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme.....”.

Operatori ekonomik INA shpk, nuk plotëson pikën 8.2, Kapaciteti Teknik të Dokumentëve Standarte të Tenderit, konkretisht gërma ”c” ku percaktohet se: “Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit eskavatoriste, automakinist dhe buldozeriste, emër/mbiemer, profil i punës, numri dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerisë së

deshmise së aftësisë profesionale” Nga verifikimi i formularit permbledhes te vetedeklarimit rezulton se nuk është deklaruar afati i vlefshmerise se deshmise se aftesise profesionale per punonjesit Manovrator.

- Operatori ekonomik “**BEQIRI**” shpk

NUIS J98624801V

Operatori ekonomik “Beqiri” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne piken 13, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ne DST, ku percaktohet: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)*”. Nga verifikimi formularit permbledhes te vetedeklarimit, ne shtojcen e makinerive rezulton se operatori ekonomik “Beqiri” Shpk, nuk ka deklaruar se disponon 1 (nje) Betonpompe.

Operatori ekonomik “Beqiri” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne piken 13, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ne DST, ku percaktohet: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)*”. Nga verifikimi formularit permbledhes te vetedeklarimit, ne shtojcen e makinerive rezulton se operatori ekonomik “Beqiri” Shpk, ka deklaruar 2(dy) Eskavator me goma por nuk ka deklaruar kapacitetin per keto mjete, cka bie ne kundershtrim me dokumentat standarte te tenderit si dhe me kerkesat per plotesimin dhe deklarimet ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces 8, pasi ne dokumentat standarte te tenderit Eskavatori me goma eshte kerkuar 0.25 m3.

Operatori ekonomik “Beqiri” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne piken 13, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ne DST, ku percaktohet: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)*”. Nga verifikimi formularit permbledhes te vetedeklarimit, ne shtojcen e makinerive rezulton se operatori ekonomik “Beqiri” Shpk, per plotesimin e kerkeses per 2 kamioncina 3.5 deri ne 5 ton, ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit mjetet me targa MK3758A, me kapacitet 3 ton - 5 ton dhe AB393HK me kapacitet 3 ton - 5 ton, cka bie ne kundershtrim me kriteret e percaktuara ne dokumentat standarte te tenderit, ku mjetet kamioncina jane kerkuar me kapacitet mbajtes 3.5-5 Ton.

- Operatori ekonomik “**Shendelli**” shpk

NUIS K07924803N

Operatori ekonomik “Shendelli” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne shkronjen c, “Sigurim i ofertes” si dhe Seksioni 3 pika 3.2, Vlefshmeria e Ofertes, ku eshte percaktuar vlefshmeria e ofertes 150 dite. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se operatori ekonomik Shendelli shpk ka paraqitur dokumentin Formulari i Sigurimit te ofertes me nr.serial 060140380055547, date 13.03.2023, ne te cilin percaktohet se “Ky sgurim eshte i vlefshmem per periudhen e specifikuar 150 dite, leshuar me date 13.03.2023., afat i cili nuk perkon me vlefshmerine e ofertes 150, periudhe e cila fillon nga momenti i hapjes së ofertave konkretisht data 15.03.2023.

Operatori ekonomik “Shendelli” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne piken 13, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ne DST, ku percaktohet: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)*, Eskavator me goma 0.25 m3, cope 2, Në pronësi ose me qera”. Nga verifikimi formularit permbledhes te vetedeklarimit, ne shtojcen e makinerive rezulton se operatori ekonomik “Shendelli” Shpk, ka deklaruar mjetin me targa AIMT 29 Eskavator me goma 0.5, cka bie ne kundershtrim me dokumentat standarte te tenderit ku mjeti eskavator me goma eshte kerkuar 0.25 m3.

- Operatori ekonomik **“B-93” shpk**

NUIS J62903508R

Operatori ekonomik “B 93” shpk nuk permbush Kriteret e Pergjitheshme te Kualifikimit, ku percaktohet se: *“Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8”*. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetedeklarimit, i paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezulton se operatori ekonomik “B 93” shpk nuk ka paraqitur formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas percaktimeve në Dokumentet Standarte të Tenderit për këtë procedurë prokurimi, në përputhje me ndryshimet përkatëse sipas Vendimit të APP-se Nr.10, datë 05.10.2022.

Operatori ekonomik “B 93” shpk nuk permbush kërkesat e percaktuara në pikën 3, Kapaciteti Ekonomik e financiar, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, në dokumentet standarte të tenderit, pasi nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetedeklarimit, rezulton se operatori ekonomik B 93 nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 dhe 2022.

Operatori ekonomik “B 93” shpk nuk permbush kërkesat e percaktuara në pikën 13, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, në DST, ku percaktohet: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)”*. Nga verifikimi formularit përmbledhës të vetedeklarimit, në shtojcën e makinerive rezulton se operatori ekonomik “B 93” Shpk, ka deklaruar Eskavator me goma 0.5, cka bie në kundërshtim me dokumentat standarte të tenderit si dhe me kërkesat për plotësimin dhe deklaratimet në formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës 8, pasi në dokumentat standarte të tenderit Eskavatori me goma është kërkuar 0.25 m3.

Operatori ekonomik “B 93” shpk nuk permbush kërkesat e percaktuara në pikën 13, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, në DST, ku percaktohet: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)”*. Nga verifikimi formularit përmbledhës të vetedeklarimit, në shtojcën e makinerive rezulton se operatori ekonomik “B 93” Shpk nuk ka deklaruar numrin e kontratës së qerases së noterise për mjetet e marra me qera si dhe targat, lejen e qarkullimit dhe nr. e shasisë, konkretisht për Mjetet Autobot Uji, Kamion 10-20 Ton, Vinc me Kosh, Kamioncine, Rul me Vibrim, Rul me Kompresor, Betonpompe dhe Minieskavator, cka bie në kundërshtim me kërkesat për plotësimin dhe deklaratimet në formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës 8.

- Operatori ekonomik **“PEPA GROUP GROUP” shpk NUIS** L42215009L

Operatori ekonomik “Pepa Group” shpk nuk plotëson pikën 5, të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit ku percaktohet: *“Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar...”* pasi stafi inxhinierik dhe teknik rezulton i angazhuar në kontratën me objekt “Rikonstruksioni i bllokut të kufizuar nga rrugët “Ali Baushi-Arben Minga-Kongresi Manastirit-Ibrahim Brahja-Xhanfize Keko” lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë.

Operatori ekonomik “Pepa Group” shpk nuk plotëson pikën 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.....”* pasi mjetet rezultojnë të angazhuara në kontratën me objekt “Rikonstruksioni i bllokut të kufizuar nga rrugët “Ali Baushi-Arben Minga-Kongresi Manastirit-Ibrahim Brahja-Xhanfize Keko”.” lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, , cka bie në kundërshtim edhe me kërkesën e gjurmës “g” , *“Operatori ekonomik duhet*

të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklarohet se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane”.

- Operatori ekonomik **“DENIS-05” shpk** **NUIS** **K51518029B**

Operatori ekonomik “Denis-05” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne piken 13, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ne DST, ku percaktohet: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)”*. Nga verifikimi formularit permbledhes te vetedeklarimit, ne shtojcen e makinerive rezulton se Operatori ekonomik “Denis-05” shpk ka deklaruar mjetin Eskavator me goma, por nuk ka deklaruar Targat, Numrin e lejes se qarkullimit, cka bie ne kundërshtim me kerkesat per plotesimin dhe deklarimet ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces 8.

Operatori ekonomik DENIS-05 shpk, nuk ploteson piken 8/8.2, te Krieteve te Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, të Dokumenteve Standarte të Tenderit, ku percaktohet se: *“Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit teknik ndertimi, elektrikist dhe hidraulik, emrin/mbiemer, profilin e punes, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument”*, Nga verifikimi ne sistemin elektronik te prokurimit rezulton se operatori ekonomik DENIS-05 shpk, nuk ka deklaruar per punonjesit elektrikist dhe hidraulik, numrin e kontratës individuale të punës, numrin dhe titullin e kualifikimit per diplomën përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.

Operatori ekonomik “DENIS-05” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne piken 13, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ne DST, ku percaktohet: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)”*. Nga verifikimi formularit permbledhes te vetedeklarimit, ne shtojcen e makinerive rezulton se operatori ekonomik “DENIS-05” Shpk, per plotesimin e kerkeses per 2 kamioncina 3.5 deri ne 5 ton, ka deklaruar Komioncina me kapacitet mbajtes 3.5-10 ton me targa AA372TS dhe AA486NK, cka bie ne kundërshtim me kriteret e percaktuara ne dokumentat standarte te tenderit, ku mjetet kamioncina jane kerkuar me kapacitet mbajtes 3.5-5 Ton.

- Operatori ekonomik **“GLAVENICA” shpk** **NUIS** **K17710805A**

Operatori ekonomik “Glavenica” shpk nuk permbush kerkesat e percaktuara ne piken 13, Kapaciteti Teknik, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ne DST, ku percaktohet: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)”*. Nga verifikimi formularit permbledhes te vetedeklarimit, ne shtojcen e makinerive rezulton se Operatori ekonomik “Glavenica” shpk ka deklaruar mjetin Eskavator me goma, por nuk ka deklaruar Targat, Numerin e Lejes se Qarkullimit, cka bie ne kundërshtim me kerkesat per plotesimin dhe deklarimet ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces 8.

Operatori ekonomik “Glavenica” shpk nuk plotëson pikën 5 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet te kete nje punesim mesatar....”*. Nga verifikimi I dokumenteve te dorezuara ne sistemin elektronik te prokurimeve rezulton se Stafi inxhinierk dhe teknik si dhe mjetet / pajisjet e deklaruara ne procedure e prokurimit me objekt “Ndërtimi i rrugës Shëngjin deri në fshatin Shën Mëri”, ku operatori ekonomik “Glavenica” shpk eshte shpallur fitues. Kjo bie në kundërshtim edhe me kërkesën e gërmës “g” *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së*

cilës deklaracion se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat e shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë”.

- Operatori ekonomik **“ED KONSTRUKSION” shpk NUIS K61625001I**

Operatori ekonomik “Ed Konstruksion” shpk nuk përmbush kërkesën sipas kritereve të përgjithshme të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entitetin kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim”* pasi nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur rezultoi se është mbështetur në kapacitetet e operatorit ekonomik “COLOMBO” shpk i cili nuk ka paraqitur një angazhim me shkrim për ofrimin e kapaciteteve mbështetëse cka bie në kundërshtim edhe me Nenin 84, pika 3 të Ligjit 162/2021.

Operatori ekonomik “Ed Konstruksion” shpk nuk përmbush kërkesën sipas kritereve të përgjithshme të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”* pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se është mbështetur në kapacitetet e operatorit ekonomik “COLOMBO” i cili në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nuk ka deklaruar shlyerjen e taksave vendore cka bie në kundërshtim edhe me pikën 3 të kapacitetit ekonomik dhe financiar: *“Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 dhe për vitin 2022 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB”*.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomikë **“KLAJGER KONSTRUKSION” shpk**, me adresë Rruga "Bardhok Biba", Njesia Administrative Nr.9, zona 9/1, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **86,022,654.20** (tetëdhjetë e gjashtë milion e njëzete e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër pike dy) lekë pa tvsh është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, me adresë: *Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **86,394,937** (tetëdhjetë e gjashtë milion e treqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO



JO

